



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti


Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-123407
Më 14.7.2015


Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, kryetari i Komunës, më 14 korrik 2015 mori këtë:

A K T V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për formimin e Komisionit për rishikimin dhe përcaktimin e lokacioneve të reja për vendosjen e objekteve të përkohshme-kiosqeve, në territorin e Komunës së Prizrenit.
2. Për anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 2.1. Afërdita Mormorina, nga DUPH, kryesuese,
 - 2.2. Dukagjin Berisha, DGJK, anëtar,
 - 2.3. Përparim Shala, DSHP, anëtar, dhe
 - 2.4. Arben Shala, DUPH, anëtar.
3. Detyrat e komisionit do të jenë: Që në afat sa më të shkurtër të rishikoj, vlerësoj, identifikoj dhe të përcaktoj lokacionet e reja të nevojshme për vendosjen e objekteve të përkohshme-kiosqet, në tërë territorin e komunës së Prizrenit dhe të njëjtat t'i propozoj me shkrim për miratim.
4. Komisioni, nga pika 2 e këtij Aktvendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me ligjin në fuqi.
5. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.
6. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komisioni i emëruar.
7. Ky Aktvendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-123403
Më 14.7.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, kryetari i Komunës, më 14 korrik 2015 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, bazuar në kërkesën e Lirije Burnikut, e evidentuar si rast social, për lirimin nga pagesa e kontributeve për rregullimin e tokës ndërtimore (taksat për leje ndërtimore-komunalive) lidhur me ndërtimin e shtëpisë familjare të banimit të saj. Kështu që obliguesja e kësaj takse, Lirije Burniku, lirohet nga taksa e lartcekur, e cila i është caktuar nga shërbimi kompetent i Komunës.
2. Lirimi nga pagesa e kontributit për rregullimin e tokës ndërtimore (taksat për leje ndërtimore-komunalive), e cila është llogarit nga shërbimi kompetent i Komunës, konsiderohen si participim (donacion) i Komunës së Prizrenit për ndërtimin e këtij objekti.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-123559
Më 14.7.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 pika 1.4 të Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e mjeteve për pagesë të reklamimit (spotit) të legalizimit të ndërtimeve pa leje, në tv dhe radiot lokale, kryetari i Komunës më 14 korrik 2015, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të reklamimit (spotet) të legalizimit të ndërtimeve pa leje (botimi dhe shpërndarjen e fletushkave informuese për qytetarë) në televizionet dhe radiot lokale, që ka të bëjë me sensibilizimin dhe informimin e qytetarëve lidhur me procedurat e trajtimeve të ndërtimeve pa leje në komunën e Prizrenit. Kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të pagesës së këtij reklamimi (spoti reklamues) në televizione dhe radiot lokale në Prizren, lejohen mjetet e nevojshme financiare.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-119166
Më 14.7.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për shtimin e kapaciteteve të ujit të pijshëm në Krajk, dhe mori këtë:


K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shtimit (rehabilitimit) të kapaciteteve të ujit të pijshëm në fshatin Krajk, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-119166
Më 14.7.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrugës “Kurtish Hasani 71”, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit të rrugës “Kurtish Hasani 71”, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-119166
Më 14.7.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e murit mbrojtës në fshatin Planjan, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit të murit mbrojtës të rrugës në fshatin Planjan, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-119166
Më 14.7.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e kanalizimit në fshatin Gjonaj, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit të kanalizimit të ujërave të zeza në fshatin Gjonaj, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-119166
Më 14.7.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrugës “Besnik Kastrati 96”-rrugë anësore 1 dhe 2, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit të rrugës “Besnik Kastrati 96”-rrugë anësore 1 dhe 2, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-119166
Më 14.7.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2015 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për renovimin, mirëmbajtjen dhe pastrimin e jazit pranë Rrapit në Marash, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e rinovimit, mirëmbajtjes dhe pastrimit të jazit që gjendet pranë Rrapit në Marash dhe ambientit përreth tij, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-119166
Më 14.7.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit: “Dizajnimi i Info Qendrës te Ura e Arastës”, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e hartimit të projektit: “Dizajnimi i Info Qendrës te Ura e Arastës” në Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-119166

Më 14.7.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për organizimin e konferencës ndërkombëtare me gazetarë dhe shoqërinë civile, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e organizimit të konferencës ndërkombëtare me gazetarë dhe shoqërinë civile, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-119166
Më 14.7.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shpalljes së tenderit për rregullimin infrastrukturës së jashtme dhe të brendshme në dy objekte shkollore në Komunën e Prizrenit, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e rregullimit të rrjetit të kanalizimit të jashtëm të Shkollës Fillore të Mesme të Ultë “Naim Frashëri” në Vlashnje dhe renovimit të njeve sanitare të Shkollës Fillore të Mesme të Ultë “Haziz Tolaj” në Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-119166
Më 14.7.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me rroba pune (veshmbathje) për punëtorët e Brigadës së Zjarrfikësve, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, për lejimin e furnizimit me rroba pune (veshmbathje) për punëtorët e Brigadës së Zjarrfikësve (50 komplete), kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-119166
Më 14.7.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 14.7.2015, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me lëndë djegëse-dru për rastet sociale të komunitetit minoritar, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

1. Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e furnizimit me lëndë djegëse-dru për rastet sociale të komunitetit minoritar, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për furnizim me 245 m³ dru.
2. 240 m³ dru do t'ju shpërndahen 120 familjeve skamnore të komunitetit minoritar ndërsa 5 m³ dru do t'ju shpërndahen degëve të ZKK-së.
3. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.
5. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja